



**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



# PULSI PUBLIK XIX

Prishtinë  
Dhjetor 2020

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e UNDP-së apo USAID-it.

# Përmbajtja

|                                                              |    |
|--------------------------------------------------------------|----|
| Lista e tabelave                                             | 4  |
| Lista e figurave                                             | 5  |
| Përmbledhje ekzekutive                                       | 6  |
| Treguesit kyç të Pulsit Publik                               | 8  |
| Drejtimi politik i Kosovës                                   | 9  |
| Siguria personale                                            | 10 |
| Indekset e Demokratizimit dhe ato të Besueshmërisë Ekonomike | 11 |
| Drejtimi Ekonomik                                            | 14 |
| Problemet madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova    | 16 |
| Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat     | 18 |
| Korrupsioni në shkallë të gjerë                              | 19 |
| Qëndrimet kundrejt votimit                                   | 21 |
| Mjedisi                                                      | 26 |
| COVID -19                                                    | 29 |
| Metodologjia                                                 | 31 |
| Peshimi i totaleve të popullatës                             | 32 |
| Përlogaritja e Indekseve                                     | 33 |

# Lista e tabelave

|                                                                                                                                 |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Tabela 1. Kënaqshmëria me institucionet kyçe ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në Kosovë                                   | 8  |
| Tabela 2. Analiza e trendeve të komponenteve të ID-së                                                                           | 13 |
| Tabela 3. Analiza e tendencave të komponenteve të IBE-së                                                                        | 14 |
| Tabela 4. Perceptimet për prevalencën e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë | 20 |

# Lista e figurave

|                                                                                                                                                       |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Figura 1. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike                                                                        | 9  |
| Figura 2. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë                                                                                                     | 10 |
| Figura 3. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike                                                                                       | 11 |
| Figura 4. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës                                                                                               | 12 |
| Figura 5. Perceptimet për problemet madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova                                                                   | 15 |
| Figura 6. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik                                                            | 17 |
| Figura 7. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat                                   | 18 |
| Figura 8. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre të shtrirjes së korrupsionit në Kosovë                                                         | 19 |
| Figura 9. Perceptimi i respondent nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë                                                               | 21 |
| Figura 10. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë                                                   | 22 |
| Figura 11. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë                                                | 22 |
| Figura 12. Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore mbahen së shpejti                                                                 | 23 |
| Figura 13. Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, sipas përkatësisë etnike                                                     | 24 |
| Figura 14. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër                           | 25 |
| Figura 15. Vetëdija e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, sipas përkatësisë etnike | 26 |
| Figura 16. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre                                | 27 |
| Figura 17. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, sipas përkatësisë etnike      | 27 |
| Figura 18. Vetëdija e të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjarëve të tyre, sipas përkatësisë etnike    | 28 |
| Figura 19. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike si dhe shëndetin fizik dhe mendor                                       | 29 |
| Figura 20. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike si dhe shëndetin fizik dhe mendor, sipas përkatësisë etnike             | 30 |
| Figura 21. Kënaqshmëria me reagimin e institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19                                       | 30 |
| Figura 22. Kënaqshmëria me reagimin e institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, sipas përkatësisë etnike             | 31 |

# Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja e Pulsit Publik XIX është e para në serinë e botimeve të rregullta që do të botohen në kuadër të projektit Pulsit Publik IV. Ajo bazohet në një anketë të opinionit të kryer me 1,306 të anketuar ndërmjet 25 nëntorit dhe 8 dhjetorit 2020. Të dhënat dhe treguesit nga anketa e opinionit zërthehen sipas përkatësisë etnike dhe gjinisë në mënyrë që të sigurohen informata të detajuara mbi dallimet në perceptime dhe problemet zhvillimore me të cilat përballen njerëzit në Kosovë.<sup>1</sup>

Gjetjet e anketës së Pulsit Publik të dhjetorit 2020 tregojnë një rënie domethënëse të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe ekzekutive dhe legislative të Kosovës, krahasuar me prillin e vitit 2020. Kënaqshmëria e regjistruar me punën e ekzekutivit është 21.3%, gjë që përbën një rënie prej 39.43 pikë përqindje nga anketa e prillit 2020 kur ishte 60.7%. Për më tepër, niveli i regjistruar i kënaqshmërisë me punën e Kryeministrit është në 23%, ndërsa me Kryetaren e Kuvendit të Kosovës ka zbritur në 46.7% nga 72.4% e regjistruar në prill 2020. Indeksi i Demokratizimit (ID) është ulur me 0.21 pikë, nga 1.53 në prill 2020 në 1.32 në dhjetor 2020. IBE-ja ka rënë me 0.14 pikë nga prilli 2020 (0.98), duke kapur vlerën prej 0.84 pikësh të matur në dhjetor 2020. ID dhe IBE maten në një shkallë nga 0 pikë (minimumi) në 3 pikë (maksimumi).

Një numër pak më i ulët i të anketuarve janë të gatshëm të protestojnë për arsye politike krahasuar me prillin e vitit 2020.<sup>2</sup> Gjithsej 30.6% e të anketuarve do të ishin të gatshëm të protestonin për arsye politike, krahasuar me 33.6% në prill 2020. Të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike tregojnë gatishmëri për të protestuar mes 31.2% të shqiptarëve të Kosovës, 19.2% të serbëve të Kosovës, dhe 26.9 % të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (boshnjakë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Ndërkohë që një pjesë domethënëse e serbëve të Kosovës (49%) janë indiferentë në lidhje me drejtimin politik të Kosovës, 60.6% e shqiptarëve të Kosovës dhe 49% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin politik të Kosovës.

Gjetjet nga anketa e opinionit të Pulsit Publik XIX tregojnë edhe ulje thelbësore të ndjenjës së sigurisë tek të anketuarit, me 68.4% që ndihen të sigurt kur janë jashtë, krahasuar me 86.3% të regjistruar në prill 2020. Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se ndjenja e sigurisë është e njëjtë për femrat (68.5%) dhe meshkujt (68.3%). Ndjenja e sigurisë në mesin e serbëve të Kosovës mbetet e njëjtë, me 46.1% që ndihen të sigurt në dhjetor 2020 krahasuar me 46.2% në prill 2020. Kjo përfaqëson një rritje të qëndrueshme të ndjenjës së sigurisë për serbët e Kosovës nga nëntori 2018 (10.4%) dhe nëntori 2019 (27.1%).

Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe problemet më urgjente me të cilat aktualisht përballen Kosova. Gjetjet tregojnë një ndryshim nga anketat e mëparshme në tre çështjet madhore që ndikojnë në mirëqenien sociale, me korrupsionin që është zëvendësuar me hapësirat urbane. Tre çështjet kryesore madhore të raportuara gjatë kësaj ankete ishin papunësia (30.9%),



<sup>1</sup>Për UNDP-në, referencat për Kosovën do të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1999).

<sup>2</sup>Edhe pse anketa e opinionit u krye në mes të 25 nëntorit dhe 8 dhjetorit 2020, në tekstin e mëtejshëm do të quhet "anketa e opinionit e dhjetorit 2020".

varfëria (20.6%) dhe problemet e hapësirës urbane (6.7%), ndërkohë që papunësia, varfëria dhe korrupsioni ishin tre shqetësimet kryesore në prill 2020. Korrupsioni ka rënë në renditje nga vendi i dytë në të pestin (nga 23.5% në prill 2020 në 5.1% aktualisht). Serbët e Kosovës i konsiderojnë marrëdhëniet ndëretnike (19.6%), papunësinë (17.6%), sigurinë publike dhe personale, varfërinë dhe problemet e hapësirës urbane (9.8% secila) si çështjet më urgjente në Kosovë. Gjithsej 78.1% e të anketuarve konsiderojnë së punësimi në institucionet publike në Kosovë nuk bëhet në baza meritore, krahasuar me prillin 2020 kur këtë e besonin 80.7% e të anketuarve. Pavarësisht nga rënia nga pozicioni i dytë në pozicionin e pestë ndër problemet madhore me të cilat Kosova po përballet aktualisht, mesatarisht, 28% e të anketuarve pohojnë se e perceptojnë që korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, një rritje prej 7.3 pikë përqindje nga prilli 2020 (20.7%) kur nga anketa e Pulsit Publik u regjistrua perceptimi më i ulët për korrupsionin në shkallë të gjerë.

Sa i përket të drejtës për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, gjithsej 8.2% thanë se dinë shumë për këtë temë, 27.4% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 37% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 27.4% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, një rritje prej 20.6 pikë përqindje nga prilli 2020 (6.8%).

Kjo përmbledhje ofron të dhëna edhe mbi qëndrimet e popullit të Kosovës ndaj votimit, të dhëna mbi ndikimin e COVID-19 në mirëqenien ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor të të anketuarve, si dhe për kënaqshmërinë e tyre me masat e ndërmarra nga institucionet e Kosovës për ta parandaluar përhapjen e COVID-19. Të dhënat shtesë të marra përmes kësaj ankete të mëparshme do të jenë të disponueshme në <https://unkt.org/public-pulse-visualiser/><sup>3</sup> UNDP-ja po e mbështet në tërë botën luftën kundër pandemisë dhe zhvillimin e ndërhyrjeve specifike për vendet me qëllim të adresimit të nevojave të shteteve ku operon UNDP-ja. Në Kosovë, UNDP-ja ka zhvilluar dy vlerësime të ndikimit socio-ekonomik të COVID-19 për ta ndihmuar Kosovën dhe institucionet ndërkombëtare në reagimin ndaj sfidave të shkaktuara nga kriza e COVID-19.



<sup>3</sup>Platforma për Vizualizimin e të Dhënave: <https://unkt.org/public-pulse-visualiser/> ASKData është platformë e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

# Treguesit kyç të Pulsit Publik

Gjetjet e anketës së Pulsit Publik të dhjetorit 2020 tregojnë një ulje substanciale të niveleve të kënaqshmërisë me institucionet kryesore të Kosovës krahasuar me anketën e opinionit të kryer në prill 2020, përveç në rastin e Presidentit të Kosovës, ku kënaqshmëria është rritur nga 18.7% në prill 2020 në 33.9% në dhjetor 2020.

Mesatarisht, 27.5% e të anketuarve janë të kënaqur me punën e institucioneve kyçe të Kosovës, duke shënuar rënie prej 15 pikë përqindjeje nga prilli 2020 (42.5%) kur u regjistrua niveli më i lartë i kënaqshmërisë që nga viti 2010, por duke shënuar rritje prej 9.9 pikë përqindjeje krahasuar me nëntorin 2019 (17.6%).<sup>4</sup> Koncretisht, kënaqshmëria me punën e Kryetares së Kuvendit (46.7%) ka rënë me 25.7 pikë përqindjeje nga prilli i vitit 2020 kur u regjistrua në 72.4%. Sidoqoftë, niveli i kënaqshmërisë me Kryetaren e Kuvendit mbetet më i larti mes institucioneve. Niveli i kënaqshmërisë me Kuvendin ka rënë nga 33.4% në prill 2020 në 22.6%, ndërsa ai me Kryeministrin ka rënë nga 65.4% në prill 2020 në 23% në dhjetor 2020. Në mënyrë të ngjashme, niveli i kënaqshmërisë me punën e ekzekutivit ka rënë nga 60.7% në prill 2020 në 21.3% në dhjetor 2020.

Nivele të ngjashme të kënaqshmërisë janë regjistruar për shumicën e institucioneve të tjera. Për shembull, kënaqshmëria me gjykatat ka rënë nga 24.8% në 23%, ndërsa niveli i kënaqshmërisë me Prokurorinë e Shtetit është rritur lehtë nga 22.3% në prill 2020 në 23% në dhjetor 2020. Të dyja institucionet tregojnë një rritje të qëndrueshme të kënaqshmërisë krahasuar me nëntorin 2019 (përkatësisht 13.6% dhe 14.2%) dhe majin 2019 (përkatësisht 18.7% dhe 16.4%).

**Tabela 1. Kënaqshmëria me institucionet kyçe ekzekutive, legislative dhe gjyqësore në Kosovë**

| Treguesit Politike            |                     | Mar -15 | Shat -15 | Prill -16 | Tet -16 | Tet -17 | Maj -18 | Nën -18 | Maj -19 | Nën -19 | Prill -20 | Dhje -20 | Trend |
|-------------------------------|---------------------|---------|----------|-----------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|----------|-------|
| Kënaqshmëria me ekzekutivin   | Qeveria             | 18.10%  | 17.30%   | 17.80%    | 20.20%  | 32.40%  | 30.00%  | 31.30%  | 17.70%  | 14.40%  | 60.70%    | 21.30%   |       |
|                               | Kryeministri        | 23.60%  | 14.60%   | 18.30%    | 19.70%  | 42.30%  | 33.20%  | 35.10%  | 36.50%  | 20.70%  | 65.40%    | 23.00%   |       |
| Kënaqshmëria me legjislativin | Kuvendi             | 19.30%  | 19.90%   | 17.30%    | 18.90%  | 31.70%  | 32.90%  | 36.10%  | 19.60%  | 18.60%  | 33.40%    | 22.60%   |       |
|                               | Kryetari i Kuvendit | 20.10%  | 19.80%   | 24.30%    | 24.90%  | 36.00%  | 31.50%  | 36.30%  | 23.60%  | 20.50%  | 72.40%    | 46.70%   |       |
| Kënaqshmëria me Presidentin   | Presidenti          | 30.20%  | 30.40%   | 45.70%    | 25.50%  | 37.60%  | 39.10%  | 38.40%  | 20.40%  | 21.20%  | 18.70%    | 33.90%   |       |
| Kënaqshmëria me gjyqësorin    | Gjykata             | 17.20%  | 13.90%   | 18.40%    | 22.10%  | 36.90%  | 31.20%  | 37.80%  | 18.70%  | 13.60%  | 24.80%    | 23.00%   |       |
|                               | Prokuroria          | 17.10%  | 12.80%   | 16.90%    | 16.30%  | 33.10%  | 29.90%  | 35.30%  | 16.40%  | 14.20%  | 22.30%    | 23.00%   |       |

<sup>4</sup>Pas votimit të mosbesimit për kabinetin ekzekutiv të udhëhequr nga z. Albin Kurti më 25 mars, 2020, kabineti i ri ekzekutiv i udhëhequr nga z. Avdullah Hoti u votua më 3 qershor 2020.



# Drejtimi politik i Kosovës

Ka rënie edhe në nivelin e pakënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës. Më shumë se gjysma e të anketuarve (59.4%) janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Ky nivel i pakënaqshmërisë është ulur me 10.2 pikë përqindje krahasuar me nëntorin 2020 (69,6%). Niveli i kënaqshmërisë me drejtimin politik të Kosovës matet në 13.4%, një rritje prej 2.7 pikë përqindjeje nga prilli 2020 dhe 3.2 pikë përqindjeje nga nëntori 2019. Gjithsej 27.2% e të anketuarve deklaruan se kanë pikëpamje neutrale mbi këtë çështje, gjë që përbën rritje prej 7.5 pikë përqindjeje krahasuar me prillin e vitit 2020 (19.7%).

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat (60.5%) janë më të pakënaqura sesa meshkujt (57.2%) me drejtimin politik të Kosovës. Në të njëjtën kohë, përqindja e meshkujve që janë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës është pak më e lartë se ajo e femrave; ndërkohë që 14.9% e meshkujve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, vetëm 11.3% e femrave deklaruan se janë të kënaqura ose shumë të kënaqura me drejtimin politik të Kosovës. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se niveli më i lartë i pakënaqshmërisë gjendet tek shqiptarët e Kosovës (59.8%), të ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (48%) dhe serbët e Kosovës (41.5%). Përqindja e të anketuarve neutralë është më e larta në mesin e serbëve të Kosovës (49%), ndjekur nga pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (26.5%) dhe shqiptarët e Kosovës (25.9%). Gjithsej 13.3% e shqiptarëve të Kosovës janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin politik të Kosovës, ndërsa vetëm 8.6% e serbëve të Kosovës tregojnë të njëjtin nivel kënaqshmërie. Gjithsej 25.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës shprehën kënaqshmëri në këtë drejtim.




Figura 1. Kënaqshmëria e të anketuarve me drejtimin politik të Kosovës

Gjithsej 30.6% e të anketuarve janë të gatshëm të marrin pjesë në protesta politike, gjë që përbën një rritje të vogël nga prilli 2020 (33.6%) dhe nëntori 2019 (31.3%) dhe një rënie të konsiderueshme nga maji 2019 (42.2%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se shqiptarët e Kosovës janë më të gatshëm të protestojnë sesa serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Në mënyrë të veçantë, 31.3% e shqiptarëve të Kosovës janë të gatshëm të protestojnë, kundrejt 19.5% të serbëve të Kosovës dhe 26.5% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës. Krahasuar me prillin e vitit 2020, gatishmëria për të protestuar për arsye politike është më e ulët për shqiptarët e Kosovës (34.7%), por më e lartë tek serbët e Kosovës (17.6%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (24.5%).





Figura 2. Përqindja e të anketuarve që do t'u bashkoheshin protestave politike

## Siguria personale

Për ta matur perceptimin për sigurinë publike, të anketuarit u pyetën nëse ndihen të sigurt apo të pasigurt kur janë jashtë në rrugë, në aspektin e dhunës dhe krimit potencial. Gjetjet tregojnë një rënie prej 17.9 pikë përqindjeje të nivelit të sigurisë krahasuar me prillin e vitit 2020, kur u regjistrua niveli më i lartë i sigurisë me 86.3% të të anketuarve që ndiheshin të sigurt në rrugët e Kosovës. Niveli i regjistruar i sigurisë prej 68.4% shënoi nivelin më të ulët të sigurisë të regjistruar në dy vitet e fundit.

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se nuk ka dallime mes meshkujve dhe femrave në perceptimin e sigurisë. Gjithsej 68.3% e meshkujve dhe 68.5% e femrave deklaruan se ndihen të sigurt kur dalin në rrugë. Kjo përfaqëson një rënie substanciale në ndjenjën e sigurisë si për femrat ashtu edhe për meshkujt krahasuar me prillin e vitit 2020, kur 85.4% e meshkujve dhe 87.2% e femrave ndiheshin të sigurt kur ishin në rrugë. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime më të mëdha, ku 68.9% e shqiptarëve të Kosovës dhe 66% e pjesëtarëve të komuniteteve tjera të Kosovës ndihen të sigurt kur janë në rrugë, krahasuar me 47% të serbëve të Kosovës. Pavarësisht niveleve të ulëta të sigurisë të raportuara nga serbët e Kosovës, të dhënat tregojnë një rritje konsistente nga maji 2018 (4.8%), nëntori 2018 (10.4%), maji

2019 (16.2%), nëntori 2019 (27.4%), dhe prilli 2020 (46.2%). Përkundrazi, rënia e perceptimit të sigurisë është regjistruar si tek shqiptarët e Kosovës ashtu edhe tek pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës.



■ I/e sigurt në rrugë  
■ I/e pasigurt në rrugë

Figura 3. Perceptimi i të anketuarve për sigurinë

## Indekset e Demokratizimit dhe ato të Besueshmërisë Ekonomike

Në përputhje me trendet në rënie, anketa e opinionit e Pulsit Publik e dhjetorit 2020 ka regjistruar një rënie të Indeksit të Demokratizimit (ID) dhe Indeksit të Besueshmërisë Ekonomike (IBE).<sup>5</sup> Më konkretisht, ID-ja aktuale qëndron në 1.32, që është 0.21 pikë më e ulët sesa në prill 2020 (1.53), i cili ishte niveli më i lartë i regjistruar nga Pulsit Publik. Kjo shifër sugjeron se më pak se gjysma e njerëzve në Kosovë kanë pikëpamje pozitive për proceset demokratike në Kosovë.

Një rënie e ngjashme mund të vërehet në IBE, që ka rënë në 0.84 nga 0.98 në prill 2020, duke sugjeruar se më shumë se dy të tretat e njerëzve nuk kanë pikëpamje pozitive për trendet ekonomike. IBE-ja aktuale ka vlerën më të ulët të regjistruar që nga marsi 2015 (0.8).

<sup>5</sup>ID-ja dhe IBE-ja janë masa të vazhdueshme nga 0 në 3, në të cilat një rezultat nga 0 në 1.5 nënkupton se shumica e popullatës e sheh negativisht demokratizimin ose trendet ekonomike, dhe rezultati nga 1.5 në 3 nënkupton se shumica e popullatës e sheh pozitivisht demokratizimin ose trendet ekonomike.




Figura 4. Indekset e Demokratizimit dhe Besueshmërisë Ekonomike

Si ID-ja ashtu edhe IBE-ja përbëhen nga një numër komponentesh që përdoren për t'i gjeneruar indekset përkatëse. ID-ja përbëhet nga nëntë komponente të paraqitura në Tabelën 2. Pyetjet që bien brenda fushëveprimit të këtij indeksi mund të marrin përgjigje me "Po, plotësisht", "Po, kryesisht", "Jo aq shumë", ose "Aspak". Tabela 2 tregon përqindjen e të anketuarve që u përgjigjën me "Po, kryesisht" ose "Po, plotësisht" në të nëntë pyetjet. Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e ID-së, të dhënat nga anketa e opinionit e dhjetorit 2020, u krahasuan me ato të gjeneruara në anketat e mëparshme. Gjetjet tregojnë se çdo komponent i ID-së i listuar në Tabelën 2 ka pësuar rënie prej prillit të vitit 2020.

Gjithsej 45.9% e të anketuarve besojnë se zgjedhjet në Kosovë janë demokratike dhe sipas standardeve ndërkombëtare, krahasuar me 66.3% në prill 2020, 62.7% në nëntor 2019 dhe 35.6% në maj 2019. Gati gjysma e njerëzve (45.6%) konsiderojnë se Kuvendi e monitoron performancën e ekzekutivit, krahasuar me 58% në prill 2020 dhe 38.6% në nëntor 2019. Komponenti i gjyqësorit ka pësuar një rënie të lehtë në 36.7% nga 39.7% në prill 2020. Gjithsej 57.9% e të anketuarve konsiderojnë se mediat e gëzojnë lirinë e shprehjes, duke e bërë këtë komponentin më pozitivisht të vlerësuar të ID-së, por me vlerë më të ulët se në prill 2020, kur kjo shifër ishte 69.1%. Një rënie prej 4.7 pikë përqindjeje (45.8%) nga prilli i vitit 2020 vërehet në perceptimet për rolin e organizatave të shoqërisë civile si monitorues të vërtetë të ekzekutivit.

Rënie është regjistruar edhe në perceptimet nëse institucionet lokale dhe qendrore punojnë sipas prioriteteve të popullit të Kosovës, përkatësisht me 41.5% dhe 30.6%, krahasuar me prillin 2020 kur këto shifra ishin 56.7% dhe 54.9%, përkatësisht. Një rënie e ngjashme vërehet në përgjigjet e pyetjes nëse Kushtetuta dhe ligjet në fuqi janë demokratike dhe nëse përputhen me standardet e të drejtave të njeriut, me vetëm 42.8% përgjigje pozitive. Kjo paraqet një rënie prej

21.2 pikë përqindjeje krahasuar me prillin e vitit 2020. Për fund, krahasuar me prillin 2020 vërehet një rënie prej 6.3 pikë përqindjeje në përgjigjet ndaj pyetjeve nëse proceset demokratike në Kosovë janë krijuar dhe po shkojnë në drejtimin e duhur. Anketa e Pulsit Publik e dhjetorit 2020 regjistroi 36.2% përgjigje pozitive ndaj këtyre pyetjeve krahasuar me 42.5% në prill 2020. Sidoqoftë, kjo paraqet rritje krahasuar me nëntorin 2019 (33%). Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se të trija grupet, përkatësisht shqiptarët e Kosovës, serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës, iu përgjigjën negativisht pyetjeve më lart me “aspak” dhe “jo aq shumë”. Përgjigjet bëjnë të anketuarit shqiptarë të Kosovës, shumica e të cilëve (57.7%) besojnë se mediat e gëzojnë lirinë e shprehjes. Në pyetjet e tjera, ngjashëm me serbët e Kosovës dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës, shumica e shqiptarëve të Kosovës u përgjigjën me “aspak” dhe “jo aq shumë”.

Tabela 2. Analiza e trendeve të komponenteve të ID-së

| Po Kryesisht dhe Po plotësisht                                                                                                | Mar -15 | Shat -15 | Prill -16 | Tet -16 | Tet -17 | Maj -18 | Nën -18 | Maj -19 | Nën -19 | Prill -20 | Dhje -20 | Trend |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|----------|-----------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|----------|-------|
| A janë zgjedhjet në Kosovë demokratike dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare?                                          | 26.20%  | 23.00%   | 30.30%    | 28.00%  | 44.60%  | 50.90%  | 53.70%  | 35.60%  | 62.73%  | 66.30%    | 45.87%   |       |
| A e monitoron Kuvendi performancën e qeverisë?                                                                                | 21.20%  | 21.80%   | 26.60%    | 30.80%  | 36.10%  | 46.70%  | 48.30%  | 38.10%  | 38.61%  | 58.00%    | 45.56%   |       |
| A është sistemi i gjyqësorit në Kosovë i pavarur në vendimet e tij?                                                           | 13.60%  | 17.60%   | 21.00%    | 21.60%  | 31.20%  | 43.60%  | 46.00%  | 21.50%  | 31.48%  | 39.70%    | 36.66%   |       |
| A e gëzojnë mediat në Kosovë lirinë e shprehjes?                                                                              | 35.50%  | 46.50%   | 47.30%    | 42.30%  | 52.50%  | 52.80%  | 59.10%  | 45.60%  | 46.66%  | 69.10%    | 57.94%   |       |
| A shërben Shoqëria Civile në Kosovë si monitorues i singertë i zhvillimeve demokratike në Kosovë?                             | 19.50%  | 23.10%   | 32.10%    | 30.10%  | 34.30%  | 48.30%  | 57.50%  | 32.60%  | 34.79%  | 50.70%    | 45.77%   |       |
| A funksionon qeverisja juaj lokale (komunale) sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?                                    | 23.30%  | 27.20%   | 28.90%    | 30.40%  | 34.00%  | 50.20%  | 49.20%  | 29.80%  | 29.62%  | 56.70%    | 41.53%   |       |
| A funksionon qeveria e Kosovës sipas prioriteteve të qytetarëve të Kosovës?                                                   | 11.80%  | 15.50%   | 18.90%    | 17.90%  | 24.70%  | 39.90%  | 37.50%  | 18.10%  | 24.23%  | 54.90%    | 30.61%   |       |
| A janë kushtetuta e Kosovës dhe ligjet në fuqi demokratike dhe a i respektojnë të drejtat e njeriut?                          | 23.50%  | 19.80%   | 31.70%    | 31.80%  | 41.40%  | 53.40%  | 60.50%  | 33.40%  | 40.30%  | 64.00%    | 42.82%   |       |
| Pavarësisht nga politika e përditshme dhe me vështrimin drejt së ardhmes, a e pranoi se proceset shkojnë në drejtimin e duhur | 17.30%  | 15.40%   | 23.10%    | 23.80%  | 29.70%  | 46.90%  | 57.20%  | 22.40%  | 33.01%  | 42.50%    | 36.22%   |       |

Për të përcaktuar se cilët tregues ndikuan në uljen e IBE-së, përgjigjet aktuale pozitive të komponenteve të IBE-së u krahasuan me ato të mbledhura në anketat e mëparshme të opinionit, siç tregohet në Tabelën 3. Përgjigjet e mundshme për pyetjet që kanë të bëjnë me IBE-në janë “të favorshme”, “jo të favorshme” dhe “neutrale”. Vetëm 11.5% e të anketuarve kanë pritshmëri të favorshme në lidhje me të hyrat totale të familjes brenda gjashtë muajve, duke shënuar një rënie prej 2.7 pikë përqindjeje nga prilli 2020 (14.2%) dhe rënie prej 2.2 pikë përqindjeje nga nëntori 2019 (13.7%). Vetëm 7.2% e të anketuarve i shohin në mënyrë të favorshme kushtet për të bërë biznes në Kosovë – një rënie nga vlera prej 8.2% në nëntor 2019, por rritje nga maji 2019 (5.5%). Ngjashëm, vetëm 5.6% e të anketuarve i shohin në mënyrë të favorshme kushtet aktuale të punësimit, gjë që paraqet rënie nga vlera prej 6.6% në prill 2020 dhe 7.4% në nëntor 2019, dhe nga maji 2019 (5.8%). Për fund, 8.3% e të gjithë të anketuarve i shohin në mënyrë të favorshme kushtet e ardhshme të punësimit – gjashtë muaj nga anketa e opinionit e dhjetorit 2020, gjë që paraqet rënie prej 3.3 pikë përqindjeje nga prilli 2020 (11.65%). Si të përmbledhura, komponentet e IBE-së sugjerojnë se mbi dy të tretat e kosovarëve kanë pikëpamje mjaft pesimiste për ekonominë.

Tabela 3. Analiza e tendencave të komponenteve të IBE-së

| Të favorshme                                                                                      | Mar<br>-15 | Shat<br>-15 | Prill<br>-16 | Tet<br>-16 | Tet<br>-17 | Maj<br>-18 | Nën<br>-18 | Maj<br>-19 | Nën<br>-19 | Prill<br>-20 | Dhje<br>-20 | Trend |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|-------------|--------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|--------------|-------------|-------|
| Cilat janë pritshmërit tua në lidhje me të ardhurat totale të familjes suaj gjashtë muaj nga sot? | 15.10%     | 15.90%      | 23.40%       | 18.00%     | 22.40%     | 19.90%     | 18.80%     | 11.60%     | 13.70%     | 14.20%       | 11.50%      |       |
| Cili është vlerësimi i juaj i kushteve aktuale të biznesit?                                       | 8.10%      | 8.30%       | 14.40%       | 13.10%     | 17.90%     | 18.50%     | 16.70%     | 5.50%      | 9.10%      | 8.20%        | 7.20%       |       |
| Cili është vlerësimi i juaj për gjendjen aktuale të punësimit?                                    | 5.00%      | 6.80%       | 10.30%       | 7.70%      | 17.10%     | 15.40%     | 15.90%     | 5.80%      | 7.40%      | 6.60%        | 5.60%       |       |
| Cilat janë pritshmërit tuaja në lidhje me kushtet e punësimit gjashtë muaj nga sot?               | 6.00%      | 8.00%       | 14.00%       | 10.70%     | 18.70%     | 17.80%     | 23.30%     | 4.60%      | 12.00%     | 11.60%       | 8.30%       |       |

## Drejtimi Ekonomik

Vërehet rënie e kënaqshmërisë me drejtimin ekonomik të Kosovës krahasuar me prillin e vitit 2020 (10.7%), me vetëm 6.9% që janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Ndërkohë që 64.3% e të anketuarve janë shumë të pakënaqur ose të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, 28.8% nuk janë as të kënaqur as të pakënaqur. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës mes femrave dhe meshkujve është afërsisht e njëjtë: 6.2% e femrave janë të kënaqura ose shumë të kënaqura, dhe 7.3% e meshkujve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Për rrjedhojë, 64.8% e meshkujve janë të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, kundrejt 61.4% të femrave që ndihen njësoj. Të dhënat e zërthyer sipas

përkatësisë etnike sugjerojnë se serbët e Kosovës janë më pak të pakënaqur (50.9%) sesa shqiptarët e Kosovës (62.9%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (66%). Në të njëjtën kohë, pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës duken plotësisht të pakënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës, me 0.5% që janë të kënaqur (7.8% në prill 2020). Vetëm 1.9% e serbëve të Kosovës raportuan kënaqshmëri me drejtimin ekonomik të Kosovës, krahasuar me 7.3% të shqiptarëve të Kosovës.




Figura 5. Kënaqshmëria me drejtimin ekonomik të Kosovës



# Problemet madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova

Një përqindje e madhe e të anketuarve vazhdojnë t'i identifikojnë papunësinë dhe varfërinë si dy problemet madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova. Kjo dallon nga anketat e mëparshme, kur një nga problemet kryesore ishte korrupsioni. Anketa e fundit tregon rënien e korrupsionit në nivelin e problemit të pestë më të madh. Problemi më i madh për 30.9% të të anketuarve është papunësia, e ndjekur nga varfëria (20.6%) dhe problemet e hapësirës urbane (6.7%).<sup>6</sup> Në prill 2020, papunësia (37.2%), korrupsioni (23.5%) dhe varfëria (15.3%) ishin tre problemet madhore me të cilat përballej Kosova. Siç shihet nga këto trende, ka një rritje në përqindjen e të anketuarve që e shohin varfërinë si një problem madhor, por një rënie tek ata që e shohin papunësinë dhe korrupsionin si probleme madhore. Nuk është për t'u habitur që gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, shërbimet e kujdesit shëndetësor janë problemi i katërt madhor (6.2%). Gjetjet e tjera tregojnë se problemet sociale (4.2%), ndotja e mjedisit (3.5%) dhe çmimet e shërbimeve publike (3.1%) konsiderohen si probleme madhore në Kosovë. Gjithsej 2.4% e të anketuarve konsiderojnë se në Kosovë arsimiti është çështja më urgjente për t'u trajtuar.

Ndërkohë që anketa e opinionit e dhjetorit 2020 nuk shënon ndonjë dallim gjinor mes opinionëve të femrave dhe meshkujve mbi tre problemet madhore, të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat (23.1%) janë më të shqetësuara sesa meshkujt (18.2%) për sa i përket problemit të varfërisë. Megjithatë, meshkujt (32%) janë më të shqetësuar sesa femrat (28.8%) për papunësinë. Për fund, femrat (6.9%) janë pak më të shqetësuara për problemet urbane sesa meshkujt (6.4%).

Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë ndryshime mes komuniteteve të ndryshme etnike në renditjen e problemeve madhore. Kështu, për shqiptarët e Kosovës, tre çështjet më urgjente janë papunësia (30.2%), varfëria (21.1%) dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor (6.5%). Serbët e Kosovës i konsiderojnë papunësinë (18.1%), marrëdhëniet ndëretnike (18.1%) dhe sigurinë publike dhe personale (10.5%) si çështjet më urgjente në Kosovë, ndërsa pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës i perceptojnë papunësinë (48%), problemet urbane (12.5%) dhe varfërinë (11%) si problemet madhore në Kosovë. Teksa një numër i papërfillshëm i serbëve të Kosovës (1.9%) mendojnë se korrupsioni është problem madhor në Kosovë, të njëjtën gjë e mendojnë 7.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës dhe 5% e shqiptarëve të Kosovës.



<sup>6</sup>Problemet e hapësirës urbane përfshijnë ndërtimet e paligjshme, mbledhjen e mbeturinave dhe trafikun.






Figura 6. Perceptimet për problemet madhore me të cilat aktualisht përballet Kosova

# Rekrutimi në baza meritore në sektorin publik dhe privat

Anketa e opinionit e dhjetorit 2020 tregon se 21.9% e të anketuarve konsiderojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, kurse 78.1% mendojnë se punësimi në sektorin publik nuk bëhet në baza meritore. Gjetjet tregojnë ndryshim minimal nga anketa e prillit 2020 kur 19.5% e të anketuarve menduan se punësimi ishte në baza meritore dhe 80.7% mendonin se nuk ishte në baza meritore. Të anketuarit i konsiderojnë faktorët në vijim si kryesorët për punësimin në sektorin publik: lidhja partiake (23.3%), lidhjet familjare (23.2%), ryshfeti (20.3%), arsimimi (11.2%), miqtë (8.9%), dhe në masë më të vogël shtrirja e trajnimit profesional (6.6%), përvoja profesionale (4.1%) dhe paraqitja (2.1%). Gjithsej 21.9% e të anketuarve besojnë se arsimi, aftësimi profesional dhe përvoja profesionale janë faktorë të rëndësishëm në sigurimin e punësimit në sektorin publik.

Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se gjithsej 48.9% e meshkujve besojnë se punësimi në sektorin publik bëhet në baza meritore, krahasuar me 42.4% të femrave që mendojnë të njëjtën gjë. Si për meshkujt (24.9%) ashtu edhe për femrat (29.9%), lidhjet familjare janë mënyra më e dobishme për punësim në sektorin publik. Sidoqoftë, të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime ndërmjet perceptimeve të komuniteteve të ndryshme, me më pak besim tek shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës dhe më shumë besim tek pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës. Për shembull, ndërkohë që vetëm 20.5% e shqiptarëve të Kosovës dhe 27.6% e serbëve deklaruan se përvoja profesionale, aftësimi profesional dhe arsimimi janë faktorë të rëndësishëm për të siguruar punësim, besimi në punësim në baza meritore në sektorin publik është më i lartë mes pjesëtarëve të komuniteteve të tjera në Kosovë, 44% e të cilëve besojnë se kjo është e vërtetë.




Figura 7. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik

Për ndryshim nga perceptimi për punësimin në sektorin publik, 47.7% e të anketuarve besojnë se përvoja profesionale, arsimimi dhe formimi profesional janë të rëndësishme për t'u punësuar në sektorin privat. Gjithsej 52.6% e të anketuarve besojnë se punësimi në sektorin privat nuk bëhet në baza meritore. Të anketuarit i identifikuan faktorët e mëposhtëm si jo meritore për sigurimin e punësimit në sektorin privat: lidhjet familjare (28.3%), miqtë (11.5%), ryshfeti (6.7%), paraqitja e jashtme (3.2%), lidhjet partiake (2.3%) dhe, në një masë më të vogël, gjinia (0.3%).

Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë tregojnë se meshkujt kanë më shumë besim për punësimin në baza meritore në sektorin privat sesa femrat. Për shembull, 48.9% e meshkujve dhe 42.4% e femrave besojnë se meritokracia është faktor i rëndësishëm për të siguruar punësim në sektorin privat. Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë edhe dallime në perceptimet rreth meritokracisë në sektorin privat. Për shembull, 45.7% e shqiptarëve të Kosovës, 58.1% e serbëve të Kosovës, dhe 53.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, besojnë se faktorët meritore, si përvoja profesionale, arsimimi dhe aftësimi profesional, janë çelësi për gjetjen e një pune në sektorin privat në Kosovë.




Figura 8. Perceptimet për rolin e meritokracisë në arritjen e punësimit në sektorin publik kundrejt sektorit privat

## Korrupsioni në shkallë të gjerë

Mesatarisht, 28% e anketuarve pohojnë se korrupsioni në shkallë të gjerë është i pranishëm në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë. Kjo vlerë përfaqëson një rritje prej 7.3 pikë

përqindjeje nga ajo e anketës së opinionit të prillit 2020 (20.7%). Sidoqoftë, është më e ulët se nëntori 2019 (34.4%) dhe maji 2019 (30.1%). Perceptimi i prillit 2020 për korrupsionin në shkallë të gjerë ishte vlera më e ulët e regjistruar ndonjëherë nga Pulsi Publik.

Perceptimet për korrupsionin në shkallë të gjerë luhaten nga vlera më e ulët prej 15.2% që pretendonin se është i përhapur në Policinë e Kosovës, tek vlera më e lartë prej 39.2% që u përgjigjën se është i përhapur në Doganën e Kosovës. Ndryshimet më të mëdha në perceptime janë vërejtur në institucionet e mëposhtme: në Organizatat Ndërkombëtare (23.8% krahasuar me 5.5% në prill 2020), sistemin e kujdesit shëndetësor (25% krahasuar me 11% në prill 2020), Administratën Tatimore të Kosovës (30.2% krahasuar me 18.9% në prill 2020), komunat (24.7% krahasuar me 13.3% në prill 2020). Dogana (39.2%), Agjencia Kosovare e Privatizimit (39%) dhe Posta dhe Telekom i Kosovës (33.2%) mbeten tre institucionet që prijnë për nivelin më të lartë të perceptuar të korrupsionit në shkallë të gjerë. Institucionet me vlerat më të ulëta të korrupsionit të perceptuar në shkallë të gjerë janë Policia e Kosovës (15.3%), sektori i arsimit (19.5%) dhe Organizatat Ndërkombëtare (23.8%).

**Tabela 4. Perceptimet për përhapjen e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në Kosovë**

|                                                      | Mar<br>-15 | Shat<br>-15 | Prill<br>-16 | Tet<br>-16 | Tet<br>-17 | Maj<br>-18 | Nën<br>-18 | Maj<br>-19 | Nën<br>-19 | Prill<br>-20 | Dhje<br>-20 | Trend |
|------------------------------------------------------|------------|-------------|--------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|--------------|-------------|-------|
| Shëndetësia (spitalet dhe qendrat e mjekësis familj) | 52.60%     | 51.50%      | 37.90%       | 49.70%     | 25.50%     | 32.50%     | 25.70%     | 25.10%     | 33.40%     | 11%          | 25%         |       |
| KEDS                                                 | 44.70%     | 35.60%      | 31.10%       | 31.40%     | 20.50%     | 33.00%     | 31.30%     | 40.70%     | 38.90%     | 27.30%       | 28.70%      |       |
| KEK                                                  |            |             |              |            |            |            |            |            |            |              | 27.50%      |       |
| Gjykata                                              | 42.90%     | 46.90%      | 42.30%       | 49.30%     | 24.90%     | 38.60%     | 29.10%     | 30.70%     | 42.00%     | 24.50%       | 31.60%      |       |
| Doganat                                              | 38.70%     | 41.30%      | 32.30%       | 45.20%     | 22.70%     | 39.10%     | 31.40%     | 29.30%     | 41.40%     | 30.60%       | 39.20%      |       |
| Administrata qendrore/<br>qeveria                    | 38.50%     | 36.00%      | 36.60%       | 49.20%     | 30.70%     | 34.70%     | 28.40%     | 36.70%     | 35.30%     | 20.80%       | 29.50%      |       |
| AKP (Agjencia Kosovare<br>e Privatizimit)            | 37.10%     | 38.30%      | 39.20%       | 45.70%     | 24.90%     | 34.50%     | 29.80%     | 40.70%     | 48.10%     | 36.60%       | 39.00%      |       |
| Komunat (qeverisja<br>lokale)                        | 33.80%     | 28.60%      | 30.00%       | 40.20%     | 25.50%     | 29.00%     | 26.40%     | 25.80%     | 29.80%     | 13.30%       | 24.70%      |       |
| Arsimi (shkollat,<br>Universiteti)                   | 29.30%     | 29.00%      | 17.50%       | 31.00%     | 16.30%     | 26.20%     | 19.90%     | 20.70%     | 26.10%     | 13.60%       | 19.50%      |       |
| ATK (Administrata<br>Tatimore e Kosovës)             | 28.10%     | 25.00%      | 18.20%       | 32.50%     | 17.40%     | 28.90%     | 25.40%     | 35.30%     | 42.20%     | 18.90%       | 30.20%      |       |
| PTK                                                  | 25.90%     | 25.20%      | 18.40%       | 29.60%     | 17.00%     | 27.80%     | 25.60%     | 44.20%     | 40.80%     | 37.90%       | 32.20%      |       |
| Bankat                                               | 24.30%     | 23.30%      | 23.10%       | 24.40%     | 13.10%     | 27.30%     | 26.10%     | 33.80%     | 34.10%     | 18.90%       | 28.10%      |       |
| Organizatat<br>ndërkombëtare                         | 24.40%     | 22.90%      | 16.00%       | 28.00%     | 10.80%     | 24.50%     | 10.70%     | 19.50%     | 23.60%     | 5.50%        | 23.80%      |       |
| Policinë e Kosovës (PK)                              | 20.40%     | 19.00%      | 13.60%       | 21.10%     | 14.90%     | 25.70%     | 21.60%     | 17.00%     | 20.70%     | 9.80%        | 15.30%      |       |

Për ta kuptuar se çka i formon perceptimet për praninë e korrupsionit në shkallë të gjerë në institucionet publike dhe ndërkombëtare në Kosovë, të anketuarit u pyetën për arsyet e vlerësimit të tyre për shtrirjen e korrupsionit. Ngjashëm me anketat e tjera në të kaluarën, gjetjet tregojnë se shumica e të anketuarve (66%) i kanë formuar opinionet e tyre përmes mediave të shkruara dhe elektronike, siç ilustron Figura 9. Gjithsej 27.2% e të anketuarve deklaruan se bisedat me të afërmit dhe miqtë e formojnë bazën e opinionëve të tyre në lidhje me shtrirjen e korrupsionit, ndërsa 6.6% e të anketuarve pohuan se në opinionet e tyre kanë ndikuar përvojat personale kur atyre u janë kërkuar para, dhurata ose favore të tjera në këmbim të shërbimeve të caktuara. Vlen të përmendet se shifra e fundit është ulur me 6.5 pikë përqindjeje krahasuar me anketën e opinionit të prillit 2020 (13.1%).




Figura 9. Arsyet e të anketuarve për vlerësimin e tyre të shtrirjes së korrupsionit në Kosovë

## Qëndrimet kundrejt votimit

Anketa e opinionit e Pulsit Publik hulumtoi edhe qëndrimet e qytetarëve të Kosovës kundrejt votimit. Qëndrimet kundrejt votimit kanë ndryshuar dukshëm, duke e theksuar ndjenjën e zhvlerësimit të njerëzve përballë politikës në Kosovë krahasuar me prillin 2020. Në pyetjen nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, 34.1% e të anketuarve deklaruan se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, krahasuar me 46.7% në prill 2020 dhe 35.5% në nëntor 2019. Nga ana tjetër, 27.4% konsiderojnë se vota e tyre nuk mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, krahasuar me 26.8% në prill 2020, 29.2 në nëntor 2019, 49% në maj 2019, 46% në nëntor 2018 dhe 43% në maj 2018. Gjithsej 32.3% konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën deri në një farë mase, ndërsa vetëm 6.2% nuk e dinë nëse vota e tyre mund të sjellë ndryshime ose refuzuan të përgjigjen.




Figura 10. Perceptimi i të anketuarve nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë

Të dhënat e zërthyera sipas gjinisë tregojnë se femrat janë më skeptike sesa meshkujt kur është fjala për ndikimin e votës së tyre. Ndërkohë që 40% e meshkujve konsiderojnë se vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë, vetëm 28% e femrave e mendojnë të njëjtën gjë.





Figura 11. Perceptimi i meshkujve dhe femrave nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë


Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime të konsiderueshme në besimin në zgjedhje si një mekanizëm për të sjellë ndryshime në Kosovë. Vetëm 8.1% e serbëve të Kosovës (7.6% në prill 2020) konsiderojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime në Kosovë kundrejt 35.5% të shqiptarëve të Kosovës (48.4% në prill 2020) dhe 26.5% të pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (35% në prill 2020). Teksa 42.4% e serbëve të Kosovës nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime, njëjtë mendojnë 25.8% e shqiptarëve të Kosovës dhe 37% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.

Përqindja aktuale e serbëve të Kosovës që nuk besojnë se vota e tyre mund të sjellë ndryshime është më e ulët se prilli 2020 (61%) dhe nëntori 2018 (61.5%). Të gjitha grupet etnike besojnë ngjashëm për mundësinë që votat e tyre mund të sjellin ndryshime deri në një farë mase, përkatësisht 32.9% e shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës dhe 24.2% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës.



**Figura 12. Perceptimi i komuniteteve të ndryshme nëse vota e tyre mund ta ndryshojë situatën në Kosovë**

Anketa e Pulsit Publik hulumtoi edhe për gjasat e të anketuarve për të votuar dhe preferencat e tyre për votim. Gjetjet tregojnë se 80.9% e të anketuarve (krahasuar me 70.2% në prill 2020, 62% në nëntor 2019 dhe 73.5% në maj 2019) do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin në të ardhmen e afërt. Ndërkohë që 9.2% e të anketuarve nuk kanë pasur ndonjë preferencë politike (krahasuar me 13.9% në prill 2020), 7% e të anketuarve thanë se nuk do të votonin (7.4% në prill 2020, 7.8% në nëntor 2019 dhe 11.4% në maj 2019), dhe 2.9% nuk iu përgjigjën pyetjes.



**Figura 13. Gjasat që të anketuarit të votojnë nëse votimet qendrore do të mbaheshin së shpejti.**

Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se nuk ka dallime të konsiderueshme mes meshkujve dhe femrave në lidhje me gjasat që të votojnë nëse zgjedhjet qendrore do të mbaheshin së shpejti (93.4% meshkujt, 92.2% femrat). Sidoqoftë, të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se më pak serbë të Kosovës do të votonin tani sesa në prill 2020, krahasuar me më shumë shqiptarë të Kosovës dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës. Gjegjësisht, 59.1% e serbëve të Kosovës do të votonin tani, krahasuar me 68.1% në prill 2020; kjo shifër është më e lartë se 40.4% në nëntor 2019. Gjithsej do të votonin 84.4% e shqiptarëve të Kosovës, krahasuar me 69.8% në prill 2020, dhe 89.4% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, krahasuar me 71% në prill 2020, që do ta bënin të njëjtën gjë. Gjithsej 9.2% e shqiptarëve të Kosovës, 16.7% e serbëve të Kosovës (12.4% në prill 2020), dhe 5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës nuk kishin preferenca politike, ndërsa 6.4% e shqiptarëve të Kosovës, 24.2% e serbëve të Kosovës (13.8% në prill 2020), dhe 5.5% e komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se nuk do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti. Vlen të përmendet se në kundërshtim me rastin e shqiptarëve të Kosovës dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, numri i serbëve të Kosovës që nuk kanë ndonjë preferencë politike si dhe i atyre që nuk do të votojnë është rritur ndjeshëm krahasuar me anketën e opinionit të prillit 2020.







Figura 14. Gjasat që të anketuarit të votojnë dhe preferencat e votimit, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike

# Mjedisi

Për ta matur vetëdijësimin e publikut për të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, të anketuarit u pyetën për njohuritë e tyre mbi të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 8.2% thanë se dinë shumë për këtë temë, 27.4% pohuan se kanë njohuri mesatare, kurse 37% e të anketuarve thanë se pak dinë për këtë temë. Gjithsej 27.4% thanë se nuk kanë njohuri për të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Duke parë trendet, rezultatet tregojnë se përqindja e njerëzve që pretenduan se dinin shumë rreth kësaj teme (8.2%) ka pasur rënie substanciale nga 19.5% në prill 2020 dhe 12.8% në nëntor 2019. Në mënyrë të ngjashme, numri i atyre që thanë se nuk kanë njohuri rreth kësaj teme është rritur nga 6.8% në prill 2020 në 27.4% në dhjetor 2020.



**Figura 15. Vetëdijësimi i të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër**

Të dhënat e zbërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë dallime thelbësore mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë në lidhje me vetëdijësimin e tyre për të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër. Gjithsej 27.1% e serbëve të Kosovës, 26.6% e shqiptarëve të Kosovës dhe 25.5% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje, gjë që paraqet një rritje në të trija grupet nga të dhënat e prillit 2020 (14.5%, 19% dhe 6% përkatësisht). Dallimi më i madh mes prillit 2020 (6%) dhe dhjetorit 2020 (26.6%) është rritja e numrit të shqiptarëve të Kosovës të cilët nuk kanë njohuri për temën. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për temën (27.1%) ose që kanë njohuri mesatare për të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm (35.2%). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përbëjnë pjesën më të madhe të të anketuarve (38.5%) që kanë pak njohuri për të drejtën për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm. Shqiptarët e Kosovës udhëheqin duke ditur shumë për këtë çështje (8.7%), pasuar nga serbët e Kosovës (4.3%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (2.5%).




Figura 16. Vetëdijësimi i të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, të dhëna të zbërthyer sipas përkatësisë etnike

Pyetja e dytë për mjedisin ishte e lidhur me vetëdijësimin e të anketuarve rreth kërcënimeve të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Teksa 6.8% e të anketuarve deklaruan se janë në dijeni të plotë në lidhje me këto kërcënime, 65.8% e të anketuarve deklaruan se kishin njohuri të pakta deri në mesatare në lidhje me këto kërcënime, dhe 27.4% deklaruan se nuk kishin njohuri për kërcënime të mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Të dhënat e zbërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të mëdha mes meshkujve dhe femrave në lidhje me këtë çështje.




Figura 17. Vetëdijësimi i të anketuarve për kërcënime potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre

Siç shihet në Figurën 18, të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike nxjerrin në pah rënien në njohuri si dhe dallimet mes grupeve etnike në lidhje me kërcënimet e mundshme mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre. Gjithsej 30.5% e serbëve të Kosovës, 26.7% e shqiptarëve të Kosovës dhe 25% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës, deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje. Dallimi më i madh mes prillit 2020 (9.4%) dhe dhjetorit 2020 (26.7%) është rritja prej 17.3 pikë përqindjeje e përqindjes së shqiptarëve të Kosovës të cilët nuk kanë njohuri për këtë çështje. Serbët e Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të të anketuarve që deklaruan se nuk kanë njohuri për këtë çështje (30.5%). Pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës përfaqësojnë pjesën më të madhe të atyre që kanë pak njohuri (45%) ose kanë njohuri mesatare (27.5%) për këtë çështje. Për fund, shqiptarët e Kosovës udhëheqin me shumë njohuri në lidhje me këtë çështje (7.1% krahasuar me 16% në prill 2020), pasuar nga serbët e Kosovës (6.2% krahasuar me 7.6% në prill 2020) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (2.5% krahasuar me 8% në prill 2020).





Figura 18. Vetëdijësimi i të anketuarve për kërcënimet potenciale mjedisore ndaj shëndetit të tyre dhe të familjeve të tyre, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike

# COVID-19

Ashtu si në botimin e mëparshëm të Pulsit Publik, edhe kjo anketë e opinionit përmbante pyetje në lidhje me pandeminë COVID-19. Të anketuarit së pari u pyetën rreth ndikimit të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike, shëndetin fizik dhe shëndetin mendor. Gjithsej 68.7% (65.9% në prill 2020) e të anketuarve deklaruan se COVID-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike, 46.9% (40.7% në prill 2020) deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik, dhe 52.8% (59% në prill 2020) deklaruan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë ndonjë ndryshim të madh në ndikimin e COVID-19 në mirëqenien ekonomike të femrave (68.3%) dhe meshkujve (68.7%). Shëndeti mendor i femrave (54%, krahasuar me 60.9% në prill 2020) ishte më i prekur sesa ai i meshkujve (50.4%, krahasuar me 57.2% në prill 2020), ndërsa niveli i ndikimit në shëndetin fizik është gjithashtu më i lartë për femrat (49.1% krahasuar me 40.7% në prill 2020) sesa për meshkujt (44.5% krahasuar me 40.6% në prill 2020).



**Figura 19. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor**

Të dhënat e zërthyer sipas përkatësisë etnike tregojnë se ndikimi i COVID-19 në mirëqenien ekonomike ka qenë thelbësor tek të anketuarit nga të gjitha komunitetet etnike: 69.5% e shqiptarëve të Kosovës, 40.4% e serbëve të Kosovës dhe 71.2% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës raportuan ndikim negativ të COVID-19 në mirëqenien e tyre ekonomike. 24.8% e shqiptarëve të Kosovës, 42.3% e serbëve të Kosovës dhe 19.2% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës deklaruan se shpërthimi i COVID-19 nuk kishte asnjë efekt në mirëqenien e tyre ekonomike. Teksa shumica e shqiptarëve të Kosovës (47.4%) raportuan se COVID-19 ka pasur ndikim në shëndetin e tyre fizik, shumica e serbëve të Kosovës (50.9%) dhe e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (47.1%) thanë se COVID-19 nuk ka ndikuar në shëndetin e tyre fizik. Ndërkohë, si shqiptarët e Kosovës (52.5%) ashtu edhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera të Kosovës (55.8%) raportuan ndikim negativ të COVID-19 në shëndetin e tyre mendor, krahasuar me serbët e Kosovës, shumica e të cilëve (45.1%) thanë se COVID-19 nuk kishte pasur ndikim në shëndetin e tyre mendor.




Figura 20. Ndikimi i situatës së krijuar nga COVID-19 në mirëqenien ekonomike dhe shëndetin fizik dhe mendor, të dhëna të zërthyer sipas përkatësisë etnike

Të anketuarit u pyetën edhe nëse janë të kënaqur me masat e ndërmarra nga institucionet publike të Kosovës për ta parandaluar përhapjen e COVID-19. Të dhënat sugjerojnë përbysjen e perceptimeve krahasuar me prillin 2020, me shumicën e të anketuarve (58%) që janë të pakënaqur me masat e qeverisë së Kosovës dhe vetëm 15.6% të kënaqur. Kjo paraqet një rënie të madhe të kënaqshmërisë nga anketa e opinionit të prillit 2020, ku 78.8% shprehën kënaqshmëri me reagimin e qeverisë së Kosovës ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë tregojnë se femrat (58.9%) janë më të pakënaqura sesa meshkujt (57%) me reagimin e qeverisë së Kosovës ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19. Vlen të përmendet se në anketën e opinionit të prillit 2020, shumica e femrave (81.5%) dhe meshkujve (76%) ishin shumë të kënaqur me reagimin e qeverisë së Kosovës ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19.




Figura 21. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19

Edhe të dhënat e zërthyera sipas përkatësisë etnike theksojnë përmbysjen e perceptimit në lidhje me masat e ndërmarra nga qeveria, nga shumica të kënaqur në prill 2020 në shumicën e pakënaqur në dhjetor 2020. Shumica e shqiptarëve të Kosovës (58.6%), serbëve të Kosovës (56.9%) dhe pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës (46.2%) janë të pakënaqur me masat e ndërmarra nga qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Vetëm 15.4% e shqiptarëve të Kosovës, 13.8% e serbëve të Kosovës dhe 21.1% e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera të Kosovës janë të kënaqur me këto masa.




Figura 22. Kënaqshmëria me reagimin i institucioneve publike ndaj krizës së shkaktuar nga shpërthimi i COVID-19, të dhëna të zërthyera sipas përkatësisë etnike

## Metodologjia

Gjetjet e paraqitura në këtë përmbledhje janë bazuar në një anketë të opinionit me 1,306 qytetarë të Kosovës mbi moshën 18 vjeçare. Në mostër janë përfshirë të dyja gjinitë, meshkuj dhe femra nga të gjitha komunat dhe rajonet e Kosovës, duke i mbuluar zonat urbane dhe rurale. Konkretisht, mostra ka përfshirë 896 shqiptarë të Kosovës, 210 serbë të Kosovës dhe 200 pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës (boshnjakë të Kosovës, ashkali të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës). Anketa u krye në bazë të mostrimit me probabilitet rastësor në etapa të shumëfishta, nga data 25 nëntor deri më 8 dhjetor 2020 përmes intervistave sy më sy. Mostra është përfaqësuese e ekonomive familjare në Kosovë.<sup>7</sup>

<sup>7</sup>Në raport përdoren termat përqindje dhe pikë përqindjeje. Një pikë përqindjeje është ndryshimi numerik mes dy përqindjeve; ndërsa përqindja është raporti i shprehur si fraksion i 100. Përqindja i referohet shkallës së ndryshimit, ndërsa pika e përqindjes e bën matjen e sasisë reale të ndryshimit.

## Peshimi i totaleve të popullatës

Anketat e Pulsit Publik marrin mostra më të mëdha të pakicave në mënyrë që të dhënat të mund të zërthehen sipas përkatësisë etnike. Megjithatë, kur bëhen përlogaritjet për totale, ekipi i Pulsit Publik bën peshimin e të dhënave sipas shifrave aktuale të popullatës. Që nga viti 2002, janë përdorur përqindjet e mëposhtme për peshimin e totaleve të popullsisë:

- Shqiptarë të Kosovës: 88%;
- Serbë të Kosovës: 6%;
- Pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës: 6%.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënave zyrtare nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, përbërja etnike aktuale në Kosovë është siç vijon:

| Përkatësia etnike                                              | Gjithsej popullsia | Përqindja e popullsisë totale |
|----------------------------------------------------------------|--------------------|-------------------------------|
| Shqiptarë të Kosovës                                           | 1,616,869          | 92.93                         |
| Serbë të Kosovës                                               | 25,532             | 1.47                          |
| Turq të Kosovës                                                | 18,738             | 1.08                          |
| Boshnjakë të Kosovës                                           | 27,533             | 1.58                          |
| Goranë të Kosovës                                              | 10,265             | 0.59                          |
| Romë të Kosovës                                                | 8,824              | 0.51                          |
| Ashkali të Kosovës                                             | 15,436             | 0.89                          |
| Egjiptas të Kosovës                                            | 11,524             | 0.66                          |
| Të tjerët, refuzuan të deklarojnë dhe nuk janë të disponueshëm | 5,104              | 0.29                          |
| <b>Gjithsej</b>                                                | <b>1,739,825</b>   | <b>100.00</b>                 |

Nëse këto shifra do të ndiqeshin për Anketat e Pulsit Publik, peshimi do të ishte si më poshtë:

- Shqiptarë të Kosovës: 93%;
- Serbë të Kosovës: 2%;
- Pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës: 5%.

Megjithatë, marrë parasysh se serbët e Kosovës në pjesën veriore të Kosovës nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011, së bashku me vlerësimin e përgjithshëm se shkalla e pjesëmarrjes së serbëve në pjesën tjetër të Kosovës është më e ulët, u vlerësua se duhet t'i



shtojmë edhe 34,000 serbë të tjerë të Kosovës, duke e sjellë në 59,532 numrin total të serbëve të Kosovës që u morën parasysh për qëllimet e këtij studimi. Ky veprim gjithashtu e rriti popullsinë e përgjithshme të Kosovës në 1,773,825. Kur merren parasysh këto ndryshime, peshimi në anketat e Pulsit Publik është bërë si në vijim:

- Shqiptarë të Kosovës: 92%;
- Serbë të Kosovës: 4%;
- Pjesëtarë të komuniteteve të tjera të Kosovës: (ashkali të Kosovës, boshnjakë të Kosovës, egjiptas të Kosovës, goranë të Kosovës, romë të Kosovës, dhe turq të Kosovës): 4%.

## Përlllogaritja e Indekseve

Indeksi i Demokratizimit është një mesatare e përbërë e bazuar në nivelin e pajtimit apo mospajtimit të të anketuarve me zhvillimet vijuese në Kosovë: shkalla e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, monitorimi i Kuvendit, performanca e institucioneve qendrore, pavarësia e sistemit gjyqësor, liria e shprehjes dhe mediave, ekzistenca e një shoqërie civile mbikëqyrëse në Kosovë, Kushtetuta dhe ligjet e bazuara në të drejtat e njeriut, dhe nëse institucionet lokale dhe qendrore punojnë në përputhje me prioritetet e qytetarëve. ID-ja është matje e vazhdueshme e cila shkon nga 0 në 3, ku rezultati prej 0 do të thotë që asnjë nga anketuarit nuk konsideron që demokratizimi është në rrugën e duhur, ndërsa rezultati prej 3 do të thotë që të gjithë të anketuarit pajtohen plotësisht se demokratizimi është në rrugën e duhur.

Indeksi i Besueshmërisë Ekonomike është një mesatare e përbërë e cila përlllogaritet në bazë të vlerësimit të të anketuarve për kushtet e favorshme ose të pafavorshme ekonomike në Kosovë. Konkretisht, të anketuarit i vlerësojnë kushtet në vijim: pritjet në lidhje me të hyrat totale të familjeve të tyre, kushtet e punësimit për gjashtë muajt e ardhshëm, dhe vlerësimin e kushteve aktuale të biznesit dhe punësimit. IBE-ja është një matje e vazhdueshme me vlera që shkojnë nga 0 në 3, ku harku prej 0 deri në 1.5 tregon një vlerësim të pafavorshëm të gjendjes ekonomike nga shumica e popullatës, kurse harku prej 1.5 deri në 3 tregon një vlerësim të favorshëm nga shumica.





**USAID**

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

